

VENDIMI ËSHTË I PLOTËFUQISHËM  
 OPIKALJE PRAVNOSNAZNA  
 GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD  
 FERIZAJ I UROSEVAC NË EMËR TË POPULLIT

Më 29.08 2018  
 Dana

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – DEPARTAMENTI I

PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI PENAL, me Gjyqtarin e vetëm gjykues Mustaf Tahiri dhe sekretaren juridike Drita Ujupi, në çështjen penale kundër të akuzuarës [REDAKTUAR] për shkak të veprës penale rrezikimi trafikut publik nga neni 378 par.8 lidhur me par.6 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP.II.nr. 1410-2/16 e datës 25.10.2017, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor publik me datë 29.01.2018, në praninë e përfaqësuesit të aktakuzës – Prokurorit të Shtetit Mimoza Sylja, të akuzuarës [REDAKTUAR] të dëmtuarve [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] të njëjtën datë mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me dt. 20.02.2018, përpiloi me shkrim këtë:

### AKT GJYKIM

E akuzuara [REDAKTUAR] nga fsh [REDAKTUAR] K.Ferizaj, e lindur më [REDAKTUAR] në të njëjtin vend, nga i ati [REDAKTUAR] dhe e ëma [REDAKTUAR] e gjinisë [REDAKTUAR] e martuar, nënë e tre fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike, e pa punë, shqiptare, shtetase e Republikës së Kosovës, me nr.përsional [REDAKTUAR].

### ËSHTË FAJTORE

Me dt.10.08.2016, rreth orës 16.15, në rrugën "Brahim Ademi" në Ferizaj, duke drejtuar automjetin e markës "Golf 5", me traga të regjistrimit [REDAKTUAR] në drejtim të Shtimes, duke vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 49/1 të LSKRR-së, nga pakujdesia kur ka arritur në përfundim të rrugës ku komunikacioni zhvillohet në dy korsi në të njëjtin drejtim duke mos e respektuar vijën e plotë, kalon në kahjen e kundërt në drejtim të lëvizjes dhe godet automjetin transportues të markës "VW LT" me targa [REDAKTUAR] të cilën e drejtonte [REDAKTUAR] me të cilin rast pos dëmeve materiale lëndime të rënda trupore pëson [REDAKTUAR], ndërsa lëndime të lehta trupore pësojnë [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] lëndime këto të përshkruara në ekspertizën mjeko-ligjore të datës 04.10.2017,-

me çka ka kryer veprën penale rrezikimi trafikut publik nga neni 378 par.8 lidhur me par.6 të KPRK-së

Andaj Gjykata në bazë nenit 378 dhe neneve 4, 7, 17, 21, 41, 42,49, 51, 64, 73, 75, 76 të KPRK-ës, dhe nenit 365 të KPPK-ës, e

## G J Y K O N

DËNIM BURGIMI NË KOHËZGJATJE PREJ 6 /GJASHTË/ MUAJ, dënim ky i cili nuk do të ekzekutohet nëse e akuzuara në periudhën prej 1/NJË/VITI pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë nuk kryen vepër tjetër penale.

Të dëmtuarit [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR] komuna Ferizaj, [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR] komuna Ferizaj, [REDAKTUAR] nga Ferizaj, rr [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Obligohet e akuzuara që në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej 30/tridhjetë/€ si dhe në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shumën prej 90.88/nëntëdhjetë euro e tetëdhjetë e tetë cent/€, në afat prej 15 ditëve, nga data kur aktgjykimi të merr formën e prerë nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

## Arsyetimi

Prokuroria Themelore në Ferizaj, me aktakuzën e evidentuar PP.II.nr. 1410-2/16 e datës 25.10.2017, ka ngarkuar të pandehurën [REDAKTUAR] për shkak të veprës penale rrezikimi trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj akuze caktoi dhe mbajti seancën e shqyrtimit gjyqësor me datë 29.01.2018, në të cilën shqyrtim gjyqësor prokurori i shtetit Mimoza Sylja ka bërë rikualifikimin e veprës penale nga rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 në veprën penale rrezikimi trafikut publik nga neni 378 par.8 lidhur me par.6, pasi

sipas ekspertizës mjeko- ligjore të dt.04.10.2017I dëmtuari Avni Selmani ka pësuar lëndime te rënda trupore.

E akuzuara [REDAKTUAR] ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën e ngarkon akuza, duke shprehur pendimin për veprën penale të kryer, deri te aksidenti ka ardhur pa dëshirën e saj, në atë aksident kanë pësuar lëndime edhe vajza, motra dhe babai i saj i, dhe i premtan gjykatës që me nuk do të përsëris në të ardhmen veprën penale.

Prokurori i shtetit me rastin e paraqitjes së mendimit të tij, ka propozuar që të pranohet pranimi i fajësisë për të akuzuarin pasi që një pranim i tillë është bërë vullnetarisht nga ana e të pandehurit dhe të njëjtin ta shpall fajtor dhe ti shqiptohet një dënim i paraparë me ligj. Ndërsa në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbetet në tersi pranë akuzës së rikualifikuar dhe i propozon gjykatës që të pandehurës ti shqiptoj një dënim të paraparë me ligj.

Gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë shqyrtoi me kujdes kushtet e parapara nga neni 248 par. 1 të KPP-së dhe me këtë rast vlerësoi se e akuzuara ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht, pranimi i fajit mbështet në faktet dhe prova materiale të rastit konkret dhe atë me provat e paraqitura nga Prokurori i Shtetit siq ekspertiza e ekspertit të komunikacionit i dt.06.09.2017 si dhe ekspertiza e ekspertit të mjekësisë i dt.04.10.2017, deklarata e të pandehurit e datës 10.08.2016, deklarata e të dëmtuarit e datës 10.08.2016, fotografitë dhe provat e tjera qe gjenden në shkresat e lëndës si dhe aktakuza nuk përmban ndonjë shkelje të qartë ligjore apo faktike.

Meqenëse e akuzuara ka pranuar fajësinë, e cila është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, andaj Gjykata, konform nenit 248 par. 4 të KPP-së, ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Duke vlerësuar në aspektin juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.8 lidhur me par.6 të KPRK-së, sikurse me datë, vend dhe kohë siç është përshkruar hollësisht në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të akuzuarën, Gjykata vlerësoj rrethanat në kuptim të nenit 75 dhe 76 të KPRK-ës dhe gjeti si rrethanë lehtësuese se e

akuzuara ka pranuar fajësinë, deri më tani nuk është dënuar me aktgjykim të formës së prerë, nënë e tre fëmijëve, kurse në rastin konkret nuk gjeti rrethanë rënduese pos që vlerësoi peshën konkrete të veprës penale.

Gjykata është e bindur se edhe me dënimin e caktuar, duke marrë parasysh edhe faktin se e akuzuara ka bërë pranimin e fajësisë, do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimit i paraparë në nenin 41 të KPK-ës përkatësisht dënimi i shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm dhe në përshtatje me rrethanat e kryerjes, rrezikshmërinë e saj dhe të autorit e që do të shërbej në parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi që ti përmbaj personat e tjerë nga kryerja e veprës penale (preventiva gjenerale).

Në kuptim të nenit 463 par.2 të KPP-së, të dëmtuarit [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR] komuna Ferizaj, [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR] komuna Ferizaj, [REDAKTUAR] nga Ferizaj,rr [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Konform neneve 450 dhe 453 të KPP-ës, obligohet e akuzuara që në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë shumën prej 30/tridhjetë/€, si dhe në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shumën prej 90.88 /nëntëdhjetë euro e tetëdhjetë e tetë cent/€, të cilat obligohet që ti paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, prej ditës kur aktgjykimi merr formën e prerë.

Nga arsyet e sipër cekura është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-**  
**DEPARTAMENTI PERGJITHSHEM,**  
**P.nr. 2646/17 datë 20.02.2018.**

Sekretare juridike,

**Drita Ujupi**

Gjyqtari i vetëm gjykues,

**Mustaf Tahiri**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditëve, pas pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj.